

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 634 REP
Nr. 184 KOL

(Fuellat e tabeles shtetesore prej 900 lekeshë janë aplikuar në shprehjen e noterit)



KONTRATE DHURIMI KUOTASH

Sot, më datë 16. 03. 2006 (dymijë e gjashtë), në dhomën e noterisë Tiranë dhe para meje noter Pirro DH. STEFANI, u paraqitën personalisht palët e mëposhtëme kontraktuese:

DHURUESI:

z. Anri BUZALI, shtetas shqiptar, i biri i Perit, i dtl. 07. 06. 1976, lindur ne Korçë dhe banues ne Tiranë; në adresën Rruga "Durrësit", Pallati 228, Apt. Nr. 10 i identifikuar me pasaportën 20894961, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, që më poshtë do të quhet **Dhuruesi**;

PRANUESI I DHURIMIT:

z. Baki BERBERI, Shtetas shqiptar, lindur në Berat dhe banues në Tiranë, mbajtës i pasaportës me Nr. 0973862, i njohur personalisht prej meje, që më poshtë do të quhet **Pranuesi i Dhurimit**;

Për identitetin e palëve kontraktuese u sigurova nga pasaportat personale dhe pasi konstatova se i kanë të gjitha aftësitë ligjore, me kërkesën e tyre si dhe duke u bazuar në nenin 761 e vijues te Kodit Civil, i redaktova këtë kontrate dhurimi kuotash dhe që më poshtë përshkruhet.

Dhuruesi, z. Anri BUZALI dhe **Pranuesi i Dhurimit** z. Baki BERBERI, janë ortakë të Shoqërisë Tregtare "ALB BB AUDITING" SHPK. Sipas akteve të prezantuara përpara meje noterit, Shoqëria Tregtare "ALB BB AUDITING" SHPK, është regjistruar si person juridik pranë Zyrës së Regjistrimit Tregëtar, me Vendimin Nr. 23486 datë 28. 03. 2000 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Referuar këtij vendimi dhe Vendimit Nr. 23486/4 datë 15. 12. 2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë si dhe Statutit dhe Aktit të Themelimit të kësaj Shoqërie, Shoqëria Tregtare "ALB BB AUDITING" SHPK, ortakët rezultojnë jenë këta ortakë me këto pjesë përkatëse kapitali, ku vlera e çdo kuote është në vlerën e 2 000 lekëve:

a. z. Baki BERBERI	52 000 Lekë	Përkatësisht	26 Kuota
b. z. Lavdimir FUSHA	98 000 Lekë	Përkatësisht	49 Kuota
c. z. Anri BUZALI	50 000 50 000 Lekë	Përkatësisht	25 Kuota

Dhuruesi / mësipërm deklaron se të gjitha kuotat që ai zotëron pra 25 kuota ose 25 % të pjesëve të kapitalit që ai zotëron në këtë shoqëri, i dhuron Pranuesit të Dhurimit, z. Baki BERBERI, pa shpërblim

Referuar dhe akteve të paraqitura nga vetë ata, rezulton se Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë Tregtare "ALB BB AUDITING" SHPK, në Vendimin e saj me Nr. 05. datë 15. 03. 2006 ka vendosur lejimin e transferimit të kuotave, midis ortakëve të kësaj shoqërie.

(Signatures of the parties)

Po kështu edhe Pranuesi i Dhurimit z. Baki BERBERI deklaron se e pranon dhurimin dhe që në këtë moment njihet pronar ekskluziv dhe i pakontestueshëm i kuotave të mësipërme të dhuruara , pra 25 %, dhe Dhuruesi humbet të gjitha të drejtat e pronësise mbi këto kuota të dhuruara.

Që nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate, si dhe me vetë deklarinimin e Dhuruesit z. Anri BUZALI nuk ka më në pronësi të tij 25 % te kuotave te kapitalit të shoqërisë dhe këto të drejta i kalojë z. Baki BERBERI. Kështu Dhuruesi i humbet të gjitha të drejtat e pronësisë mbi kapitalin e dhuruar sipas kësaj kontrate te kësaj shoqërie, duke ia kaluar këto të drejta Pranuesit të Dhurimit. **Dhuruesi gjithashtu humbet çdo lloj pretendimi mbi këtë shoqëri dhe nuk është më ortak i saj.** Kështu me dhurimin e kuotave z. Baki BERBERI bëhet rtak i shoqërisë duke zotëruar 51 kuota ose 51 % të pjesëve të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kjo kontratë u hartua në bazë të neneve 761 e vijues të Kodit Civil si dhe në bazë të Ligjit Nr. 7638 datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare".

Kjo kontrate pasi iu lexua paleve dhe u gjet konform vullnetit të tyre të plotë, në prezencën time e pranuan aktin dhe e nënshkruajnë atë si më poshtë rezulton.

DHURUESI

z. Anri BUZALI


Anri Buzali



PRANUESI I DHURIMIT

z. Baki BERBERI

Baki Berberi



NOTER

PIRRO DH. STEFANI

